



Shtojca 19:

**FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

**Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit**

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomike)*

**MALBERTEX shpk**

Emri i plotë i ankimuesit

**K71821009N**

Nuis/Nipt

Rr Zenel Bastari, Blloku I Magazinave

Adresa

Tiranë

Shteti

Kodi Postar / Posta

0672026630

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

malbertex@yahoo.com

E-mail

Artan Berberi

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

2023/05/08

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

**Seksioni II. Informacion mbi procedurën**

**1. Numri i referencës së procedurës/Lotit**

*Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.*  
REF-68100-05-03-2023

## 2. Lloji i Procedurës

*Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.*

- |  |   |
|--|---|
| Procedurë e hapur<br><input type="checkbox"/>  | Procedurë e hapur e thjeshtuar<br><input checked="" type="checkbox"/>                             |
| Procedurë e kufizuar<br><input type="checkbox"/>   | Procedurë konkurruese me negociim<br><input type="checkbox"/>                                     |
| Partneritet për inovacion<br><input type="checkbox"/>  | Dialog konkurrues<br><input type="checkbox"/>   |
| Procedurë me negociim me shpallje paraprake të njoftimit<br><input type="checkbox"/>                                 | Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës<br><input type="checkbox"/> |
| Shërbim Konsulence<br><input type="checkbox"/>   |   |
| Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP<br><input type="checkbox"/> |   |

## 3. Autoriteti /Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

ECO - ELB

---

## 4. Vlera e përlogaritur e prokurimit

*(Vlera e përlogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)*

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 4,000,100 (katërmilion e njëqind) Lekë pa TVSH

---

## 5. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

*(Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuader).*

“Blerje Veshje Pune”

---

## 6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*(Data (viti/muaji/dita)*

2023/05/15

---

## 7. Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

---

8. **Data e nënshkrimit të kontratës**

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

---

**Seksioni III. Përshkrimi i ankesës**

1. Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

**LPP NR. 162/2020 “PER PROKURIMIN PUBLIK”, VKM NR. 285 “PER MIRATIMIN E RREGULLAVE TE PROKURIMIT PUBLIK” I NDRYSHUAR, etj**

---

**2. Objekti i ankesës**

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

**3. Rrethanat dhe faktet**

1. Në datë 04.052023, enti prokurues publikoi procedurën e prokurimit.

Në bazë të parashikimeve të nenit 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” po paraqesim ankesën tonë për të modifikuar kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike, si më poshtë.

#### **4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit kontraktor.*

Në datën 04.05.2023 u njohëm me DST e procedurës së prokurimit.

Nga leximi i saj konstatojmë se disa kriteret kualifikuese dhe disa specifikime teknike janë hartuar në kundërshtim me parashikimet e ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, të cilat po i rendisim si më poshtë:

##### **I. Lidhur me kriteret kualifikuese:**

1) Në kriterin e pikës 2.2.2 AK ka kërkuar që të paraqitetn bilancet e viteve 2020, 2021 dhe 2022.

Meqënëse procedura e prokurimit është e llojit “Procedure e hapur e thjeshtuar” ju drejtua parashikimeve të nenit 55 të VKM nr 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar nga ku vërejmë se AK në këtë lloj procedure prokurimi duhet të kërkojë vetëm vërtetimin e xhiros për të vërtetuar kapacitetet ekonomike.

**Pretendimi 1: Kërkojmë që AK të modifikojë DST duke hequr kriterin kualifikues të pikës 2.2.2.**

2) Në kriterin kualifikues të pikës 2.3.5 AK është shprehur si më poshtë:

##### **2.3.5 Çertifikatë OEKO-TEX**

*Ofertuesi duhet të paraqesë çertifikatë OEKO-TEX për tekstilet ,Standarti 100, klasi II(ose ekuivalente me to), të vlefshme, të prodhuesit të lëndës së parë. Në rastin kur lëndët e para sigurohen nga prodhues të ndryshëm, çertifikata ose dokumenti ekuivalent me të, duhet të paraqitet për të gjithë prodhuesit. Për këtë OE pjesëmarrës duhet të paraqesë një autorizim nga ëprodhuesi i lendes se parë ku të bëhet lidhja midis prodhuesit dhe OE/distributorit të autorizuar.*

Ndërkohë në Shtojcën 5 të DST-ve enti prokurues ka publikuar specifikimet teknike të artikujve të cilët janë kërkuar që të blihen në tender. Nga leximi i këtyre specifikimeve teknike konstatuam se për asnjë nga artikujt që janë kërkuar të blihen nuk është si specifikim teknik që copa të jetë e çertifikuar OEKO-TEX.

P.S Shikoni se çfarë shkruhet nga komisioni i hartimit te DST në :

## Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

*(Për argumentimin e kritereve te përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)*

### 2.3.5 Certifikate OEKO-TEX

*Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë OEKO-TEX për tekstilet ,Standarti 100,klasi II(ose ekuivalente me to), të vlefshme, të prodhuesit të lëndës së parë. Në rastin kur lëndët e para sigurohen nga prodhues të ndryshëm, certifikata ose dokumenti ekuivalent me të, duhet të paraqitet për të gjithë prodhuesit. Per kete OE pjesemarrës duhet te paraqese nje autorizim nga prodhuesi i lendes se pare ku te behet lidhja midis prodhuesit dhe OE/distributorit te autorizuar.*

*Për të vërtetuar pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse per artikujt: Xhup pune (fosforeshent) dhe Kominoshe pune pa krahe me rripa, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare në fuqi. (Raporte testimi për copën e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).*

*Argumentimi:Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. pika 6/ c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, AutoritetiKontraktore duke pasur parasysh natyren e mallit per te cilen prokuron kerkon nga istitucione shtetore apo private te licensuara Analiza te cilat jane ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara per produktin qe prokurohet.*

Nga njëra anë kërkon certifikatë OEKO-TEX dhe nga ana tjetër argumenton për domosdoshmerine e dëshmime për testimet zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar.

Kush duhet të jetë, kërkesa për oeko-tek apo argumenti për dëshmi të testimeve nga instucione të autorizuar?

**Pretendimi 2: Kërkojmë saktësimin, apo modifikimin e DST, përfshi argumentat e procesverbalit, duke hequr kriterin kualifikues të pikës 2.3.5, pasi në asnjë nga specifikimet teknike të Shtojcës 5 nuk është përcaktuar që copa e produkteve të jetë e certifikuar OEKO-TEX.**

## II. LIDHUR ME SPEIFIKIMET TEKNIKE:

1) Për artikullin “ Kominoshe pune pa krahe me rripa” në Shtojcën 5 janë hartuar këto specifikime teknike si më poshtë:

- *Kominoshe pune pa krahe me rripa*
- *Me mbrojtje të plotë. Kominoshet CE per punëtorët industrial të cilët janë të ekspozuar ndaj mbetjeve. Anët elastike i japin përdoruesit një përputhje me të rehatshme të veshjes dhe xhepat e shumë të mbajnë veglat dhe sendet personale të sigurta.*
- *-Certifikim CE*
- *- Rezistentë ndaj flakëve e garantuar për gjithë jetëgjatësinë e pëlhurës;*
- *- Mbrojtje nga nxehtësia rezatuese, konvektive, dhe me kontakt;*
- *- E certifikuar për mbrojtjen nga skorjet e metaleve të shkrira;*
- *- Bel elastik në anësore për komfort maksimal;*
- *- Hapje anësore e lehtë dhe e shpejtë;*
- *- Pëlhura e klasifikuar me UPF 50+ per te bllokuar 98% rrezeve UV;*
- *- 4 xhepa per vendosje te sigurte;*
- *- Artikulli duhet të jetë sipas Standarteve SSH-EN ISO 11612 (A1+A2, B1, C1, E1, F1)*
- *SSH-EN ISO 11611 Class 1 (A1+A2) ose ekuivalente me to.*
- *- E përbere nga material 99% Pambuk dhe 1% fibra karboni;*
- *-Pesha: 330 gr/m<sup>2</sup>.*

Disa nga specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2023 “Për porkurimin publik” dhe konkretisht:

1/a- Specifikimi teknik “Certifikim CE” është një specifikim që ul konkurrencën dhe që con tek produkte të cilat shiten vetëm në Bashkimin Europian dhe për këtë arsye është diskriminues, pasi na detyron që të ofertojmë vetëm produkte që kanë Çertifikimin CE.

**Pretendimi ynë për këtë specifikim teknik është që të modifikohet, duke shtuar fjalën ekuivalente, por me kushtin që të jepen sqarime të hollësishme se kush çertifikim është ekuivalent me Çertifikimin CE dhe nëse AK nuk arrin që të japë sqarime të hollesishme atëhere ta heqë fare këtë specifikim.**

1/b- Specifikimi teknik “Artikulli duhet të jetë sipas Standarteve SSH-EN ISO 11612 (A1+A2, B1, C1, E1, F1) SSH-EN ISO 11611 Class 1 (A1+A2) ose ekuivalente me to”

Nga verifikimi i këtyre standarteve të publikuara ne faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Standartizimit dhe konkretisht të “Katalogu Shqiptar i Standarteve” (në linkun: <https://dps.gov.al/sq/download/file/page-section/75>) konstatojmë se përcaktimet (A1+A2, B1, C1, E1, F1) për standartin SSH-EN ISO 11612 nuk ekzistojnë dhe se përcaktimet Class 1 (A1+A2) për standartin SSH-EN ISO 11611 nuk ekzistojnë.

**Pretendimi ynë për këtë specifikim teknik është që të modifikohet duke hequr përcaktimet (A1+A2, B1, C1, E1, F1) për standartin SSH-EN ISO 11612 dhe përcaktimet Class 1 (A1+A2) për standartin SSH-EN ISO 11611.**

1/c- Specifikimi teknik "E përbere nga material 99% Pambuk dhe 1% fibra karboni".

Ky specifikim është me përmasa fikse dhe jo me diapason duke mos na dhënë mundësinë që të ofertojmë me produkt që i ka këto të dhëna si më poshtë:

"E përbërë nga material 98% Pambuk dhe 2% fibra karboni". Pra me +/- 1

Ju informojmë se këto specifikime teknike janë edhe më të mira se ato të përcaktuara nga ju, pasi e arrijnë qëllimin tuaj për të cilin e keni vënë këtë specifikim sepse përqindja e karbonit në copën e tekstilit është i rëndësishëm për të patur vetitë që ju kërkoni dhe për të siguruar punonjësit nga zjarri dhe elektriciteti.

**Pretendimi ynë për këtë specifikim teknik është që të modifikohet duke hapur diapazonin e përqindejes së pambukut dhe përqindjes së fibrave të karbonit në tekstilin që do të përdoret për të prodhur këtë artikull dhe të mos jetë ekskluzive e një prodhuesi me të dhënat e kërkuara nga AK.**

1/d- Specifikimi teknik "Pesha: 330 gr/m<sup>2</sup>".

Ky specifikim teknik është me përmasë fikse dhe jo me diapason, ndonëse pesha nuk luan asnjë rol në qëllimin e blerjes së këtyre kominosheve për punonjësit dhe që është mbrojtja nga zjarri dhe elektriciteti, mbrojtje të cilën e siguron përqindja e fibrave të karbonit në thurjen e tekstilit që do përdoret për prodhimin e tyre.

Pra pesha në këtë rast me përmasë fikse është diskriminuese dhe ekskluzivitet i një prodhuesi të vetëm. <https://ëëë.portëest.com/products/vieë/FR37/GRR>

**Pretendmi ynë për këtë specifikim teknik është që të modifikohet duke hapur diapazonin për këtë specifikim teknik, duke mos e lënë me përmasa fikse, me qëllim që të mos jetë ekskluzive e një prodhuesi me të dhënat e kërkuara nga AK.**

P.S Në lidhje me kërkesën për artikullin "Kominoshe pune pa krahe me rripa" duam t'iu sjellim në vëmendje edhe vendimin e KPP me rastin e anulimit të procedurës me të njëjtin objekt prokurimi si dhe konkluzionet e KVO dhe KSHA të autoriteti tuaj kontraktues, kur ju citonit se pesha e materialit që do të përdoret për prodhimin e artikullit Kominoshe pune pa krahe me rripa", duhet të jetë e lehtë me qëllim që të mos pengojë punonjësit gjatë procesit të punës.

**Në pikat 2.3.6 kërkohet :**

*Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëse është prodhues ose distributor i autorizuar nga prodhuesi për artikujt objekt prokurimi. Në rast se ofertuesi nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave dhe të vërtetohet lidhja midis tyre. Autorizimi duhet të ketë të përcaktuar adresën e saktë të firmës që e ka lëshuar këtë dokument, adresën e postës elektronike, emrin, funksionin e zyrtarit nënshkrues, vulën e shoqërisë (kjo e nevojshme për AK*

në rast verifikimi), të jetë i lëshuar për këtë objekt prokurimi dhe për llogari të Autoriteti Kontraktor

Kjo kërkesë e AK nga ana jonë konsiderohet e tepërt pasi bëhet fjalë për sasi të vogla dhe artikuj me natyrë të ndryshme, përjashtuar dorezat e punes dhe maskat, si :

- Çizma te gjata 30 pale
- Kominoshe 35 pale
- Xhup pune 35 cope
- Perparse sanitare 3 cope
- Kufje akustike 10 cope

| Artikulli | Përshkrimi i mallit           | Sasia     |
|-----------|-------------------------------|-----------|
| 1.        | <b>Cizme të gjata</b>         | <b>30</b> |
| 2.        | <b>Kominoshe</b>              | <b>35</b> |
| 3.        | Jelek Fosforishent            | 250       |
| 4.        | Doreza                        | 5050      |
| 5.        | Maska                         | 6998      |
| 6.        | Përparëse një përdorimshe     | 3000      |
| 7.        | <b>Xhup pune</b>              | <b>35</b> |
| 8.        | <b>Përparëse për sanitare</b> | <b>3</b>  |
| 9.        | <b>Kufje akustike</b>         | <b>10</b> |

*2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë katalogë ose skede teknike me të dhënat teknike te miratuara nga prodhuesi për artikujt që oferton. Katalogu/skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që AK të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DST. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me specifikimet teknike të DT për përputhshmërinë e tyre.*

Ne i konsiderojmë këto kërkesa pengesë për të patur sa më shumë operatorë në këtë prokurim, si dhe jo proporcionale në raport me volumin e kontratës. Gjithë fryma e ligjit është për kërkesa minimale me qëllim që të ketë pjesmarje sa më të gjërë në çdo procedurë prokurimi. Këto kërkesa e ndalojnë pjesmarjen e më shumë operatorve.



Si përfundim kërkojmë:

- 1- Përzullimin e tenderit.
- 2- Pranimin e ankesë dhe modifikimin e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve teknike.
- 3- Kërkojmë riformulim për autorizimin e prodhuesit
- 4- Kërkojmë riformulim për katalogjet/skedat teknike.

**5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme**

Po

Jo

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkonte)*

**6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:**

**7. Lista e informacionit konfidencial:**

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes :Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**E-mail:**